



Në pajtim me nenin 4, paragrafi 8 i Rregullores së punës të Këshillit drejtues të Fondacionit Dauti, duke u bazuar në nenin 12 të Rregullores për Punën e Komisionit për veprimtarinë botuese, me qëllim të promovimit dhe përkrahjes së librit, Fondacioni për zhvillim të arsimit dhe kulturës Dauti , shpall:

## **KONKURS**

**(PËR VEPRIMTARINË BOTUESE PËR VITIN 2016)**

*Mbështetja financiare ju dedikohet fushave në vijim :*

- Veprat nga krijimtaria letrare, gjuhësore, kulturore dhe historike
- Përkthime të veprave kulmore nga gjuhë të huaja
- Studime Ekonomike, Sociale dhe Humane
- Hulumtime nga sfera Teknologjisë së Komunikimit dhe Informacionit

Në konkursin për veprimtarinë botuese për vitin 2016 do të përfshin dy kategori konkurrimi:

- I. Konkurrin për botim të plotë**
- II. Konkurrin për përkrahje të pjesshme financiare të botimeve**

## **I. Konkurrin për botim të plotë**

Në kategorinë e konkurrimit për botim të plotë, do të kenë të drejtë të aplikojnë të gjithë autorët me tekstet e tyre autoriale që do të konkurrojnë për mbështetje të tërësishme të veprave të tyre ku si botues do të paraqitet Fondacioni Dauti.

### **Kriteret ( kushtet) dhe procedurat :**

- Të drejtë aplikimi kanë autorë, persona fizikë për tekste autoriale;
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim;
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim;
- Të gjitha tekstet të jenë origjinale;
- Do të financohen vetëm përkthimet e botimeve që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që bëjnë të mundur një përmirësim domethënës ose një përparim të më tejshëm të kërkimit në fushën përkatëse;
- Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati (përndryshe janë të pavlefshme);
- Dokumentet duhet të jenë të futura në zarf;
- Ç'do person i cili do të konkurrojë duhet që të marrë dëshmi (numër të dosjes) se i ka dorëzuar dokumentet;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen prapë, mbetet në arkivin e Fondacionit;
- Dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
- Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes;

### **Në këtë konkurs nuk mund të përkrahen:**

- *Vepra tashmë të botuara*
- *Tekstet shkollore*
- *Publikimet komerciale*
- *Publikime për festa apo përkujtime*

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit
- Kopje të dorëshkrimit të gatshme për botim në CD (Punimi të jetë në Word)
- Mendimi i dy recensentëve profesional nga fusha përkatëse

*\*Për veprat e përzgjedhura në këtë konkurrim të drejtën autoriale për botim, ribotim, redaktur, lekturë, faqosje dhe shpërndarje e mban Fondacioni Dauti.*

## **II. Konkurrin për përkrahje të pjeshme financiare të botimeve**

Në kategorinë e konkurrimit, do të kenë të drejtë të aplikojnë të gjithë autorët me tekstet e tyre autorial të cilët kanë nevojë për përkrahje të pjeshme të botimeve të tyre.

### **Kriteret ( kushtet) dhe procedurat :**

- Të drejtë aplikimi kanë autorë, persona fizikë për tekste autoriale;
- Një autor ka të drejtë të aplikojë vetëm me një libër apo punim;
- Do të merren në konsideratë për botim vetëm libra ose punime që janë të gatshme për botim;
- Të gjitha tekstet të jenë origjinale;
- Do të financohen vetëm përkthimet e botimeve që shquhen për cilësi të lartë shkencore dhe që bëjnë të mundur një përmirësim domethënës ose një përparim të më tejshëm të kërkimit në fushën përkatëse;
- Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati (përndryshe janë të pavlefshme);
- Dokument që dëshmon sigurimin e mjeteve tjera financiare;
- Dokumentet duhet të jenë të futura në zarf;
- Ç'do person i cili do të konkurrojë duhet që të marrë dëshmi (numër të dosjes) se i ka dorëzuar dokumentet;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen prapë, mbetet në arkivin e Fondacionit;
- Dokumentet që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të pranohen;
- Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes;

### **Në këtë konkurs nuk mund të përkrahen:**

- *Vepra tashmë të botuara*
- *Tekstet shkollore,*
- *Publikimet komerciale;*
- *Publikime për festa apo përkujtime*

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

- Aplikacioni i plotësuar me të dhënat në detaje të aplikuesit
- Kopje të dorëshkrimit të gatshme për botim në CD
- Mendimi i dy recensentëve profesional nga fusha përkatëse
- Dokument që dëshmon sigurimin e mjeteve tjera financiare nga palë tjera

## VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Aplikacioni me dokumentacionin e kërkuar dorëzohen, nga data **01.10.2015** deri më **31.12.2015** deri në ora 13:00, në zyrën e Fondacionit Dauti *Rr.20, nr.97 Saraj, 1000 Shkup*

Shpallja e rezultateve do të bëhet gjatë muajit Shkurt , pran zyrës së Fondacionit Dauti në web faqen zyrtare [www.fondacionidauti.org](http://www.fondacionidauti.org) si dhe në [www.facebook.com/dautifoundation](http://www.facebook.com/dautifoundation).